

20101242449

L I G J
PËR THEMELIMIN E RRJETIT HULUMTUES
AKADEMIK MAQEDONAS

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen themelimi, statusi, detyrat, puna, udhëheqja, administrimi, financimi, mbikëqyrja e punës, si dhe çështje tjera të lidhura me punën e Rrjetit Hulumtues Akademik Maqedonas.

Neni 2

(1) Për zhvillimin, organizimin dhe administrimin e rrjetit unik arsimor dhe hulumtues telekomunikues në Republikën e Maqedonisë, themelohet Rrjeti Hulumtues Akademik Maqedonas (në tekstin e mëtejme: MARnet) si institucion publik, i cili kryen veprimtari me interes publik.

(2) MARnet-i e ka cilësinë e personit juridik.

(3) MARnet-i e fiton statusin e personit juridik, me regjistrimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

Neni 3

(1) Emri i institucionit publik është “Rrjeti Hulumtues Akademik Maqedonas”.

(2) Emri i shkurtër i institucionit publik është “MARnet”.

(3) Për përdorim ndërkombëtar shfrytëzohet edhe emri “Macedonian Academic and Research Network”.

(4) Selia e MARnet-it është në Shkup.

Neni 4

(1) Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë këtë kuptimin si vijojnë:

1. “Rrjet i mbyllur telekomunikues” është rrjeti telekomunikues, i dedikuar për një rreth të mbyllur shfrytëzuesish të shërbimeve telekomunikuese dhe

2. “Shfrytëzues të shërbimeve telekomunikues” janë institucionet arsimore (të arsimit të lartë, shkolla për arsim fillor dhe të mesëm), institucione hulumtuese shkencore, si dhe organizata joqeveritare të cilat kryejnë aktivitete në sferën e mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes sociale, sportit dhe kulturës.

(2) Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin e njëjtë si dhe nocionet e përdorura në Ligjin për komunikime elektronike.

Neni 5

(1) MARnet-i i kryen punët dhe detyrat, si vijojnë:

- e udhëheq rrjetin e mbyllur telekomunikues,
- e nxit zhvillimin e rrjetit të mbyllur telekomunikues,
- i planifikon, organizon dhe udhëheq me lidhjet ndërmjet shfrytëzuesve të shërbimeve telekomunikuese,
- i udhëheq, administron dhe kryen punët për furnizim dhe huazim të pajisjes së nevojshme programore, materiale dhe komunikuese,
- organizon dhe kryen trajnime dhe u jep ndihmë profesionale shfrytëzuesve të shërbimeve telekomunikuese,

- udhëheq me domenin maqedonas (domen mk),
 - siguron anëtarësi dhe bashkëpunim me organizata përkatëse ndërkombëtare,
 - kryen aktivitete kompjuterike lidhur me hulumtimin dhe zhvillimin eksperimental, në shkencat natyrore dhe tekniko-teknologjike,
 - kryen punë lidhur me softuerin (përgatit, lëshon, jep konsultime),
 - kryen konsultime lidhur me harduerin,
 - e udhëheq bazën e të dhënave dhe përpunon të dhëna,
 - e udhëheq Regjistrin unik të nëndomeneve të regjistruara në domenin-MK (në tekstin e mëtejshëm: Regjistri),
 - mirëmban sisteme telekomunikuese në rrjet të mbyllur telekomunikues,
 - kryen veprimtari botuese lidhur me realizimin e shërbimeve telekomunikuese,
 - kryen punë që kanë të bëjnë me riprodhimin e medieve kompjuterike,
 - kryen shërbime të rrjetit të mbyllur kompjuterik, për realizimin e programeve të veprimtarive arsimore,
 - kryen punë që kanë të bëjnë me lidhjen e rrjetit të mbyllur telekomunikues të shfrytëzuesëve të shërbimeve telekomunikuese,
 - siguron lidhje teknike dhe profesionale, me rrjete të ngjashme telekomunikuese jashtë vendit,
 - vendos, mban dhe zhvillon bashkëpunim me rrjete tjera telekomunikuese në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj dhe
 - kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.
- (2) MARnet-i i realizon detyrat e veta në mënyrë të pavarur, në pajtim me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

Neni 6

Për realizimin e detyrave të tij, MARnet-i mund të themelojë seksione, grupe infrastrukurore dhe njësi tjera organizative, të përcaktuara me Statutin e MARnet-it.

II. ADMINISTRIMI DHE UDHËHEQJA ME MARnet-in

Organi i administrimit

Neni 7

- (1) Organi i administrimit të MARnet-it, është Këshilli drejtues.
- (2) Anëtarët e Këshillit drejtues, i emëron dhe i shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
- (3) Këshillin drejtues e përbëjnë shtatë anëtarë dhe atë: një anëtar me propozim të ministrit për Arsime dhe Shkencë, një anëtar me propozim të ministrit për Shoqëri Informatike dhe pesë anëtarë nga të cilët nga një anëtarë nga çdo universitet shtetëror në Republikën e Maqedonisë, me propozim të Konferencës së rektorëve të universiteteve publike në Republikën e Maqedonisë.
- (4) Këshilli drejtues ka kryetar të cilin e zgjedhin anëtarët e Këshillit drejtues.
- (5) Anëtarët e Këshillit drejtues, emërohen me parimin e profesionalizmit dhe kompetencës dhe parimin e përfaqësimit të drejtë dhe përkatës, me mandat prej katër vitesh dhe mund të emërohen përsëri.

Neni 8

Për anëtarë të Këshillit drejtues mund të emërohet personi, i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ta ketë të kryer shkollimin e lartë dhe
- ta njohë gjuhën angleze.

Neni 9

Anëtari i Këshillit drejtues mund të shkarkohet para se t'i kalojë mandati, nëse:

- vet e kërkon atë,
- e zgjedh ose emëron drejtorin, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe
- nuk i miraton programin vjetor për punën e MARnet-it, planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të MARnet-it dhe raportin vjetor për punën e MARnet-it.

Neni 10

Këshilli drejtues:

- e miraton statutin e MARnet-it,
- e zgjedh dhe e shkarkon drejtorin,
- e miraton programin vjetor për punën e MARnet-it,
- e miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të MARnet-it,
- e miraton raportin vjetor për punën e MARnet-it,
- i emëron dhe shkarkon trupat punues të MARnet-it,
- i jep propozime dhe mendime për çështje të caktuara, themeluesit dhe drejtorit të MARnet-it,
- e miraton aktin e përgjithshëm për mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit,
- miraton akte të përgjithshme për shfrytëzimin e shërbimeve telekomunikuese,
- jep pëlqim për aktin për organizim dhe punë dhe aktin për sistematizim të vendeve të punës në MARnet,
- vendos për kundërshtimet lidhur me marrëdhëniet e punës, të të punësuarve në MARnet,
- miraton rregullore për punën e vet dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me statutin e MARnet-it.

Organi i udhëheqjes

Neni 11

- (1) Drejtori, është organ udhëheqës i MARnet-it.
- (2) Drejtorin e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli drejtues.
- (3) Drejtori zgjidhet nëpërmjet konkursit publik, të cilin e shpall Këshilli drejtues, në mjetet e informimit publik.
- (4) Drejtori zgjidhet për kohën prej pesë vitesh me mundësi zgjedhjeje edhe për një mandat.
- (5) Për drejtor mund të zgjidhet personi, i cili i plotëson këto kushte:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - të ketë të kryer arsimim të lartë nga sfera e teknologjive informatike dhe komunikuese,
 - të ketë njohuri specialistike nga sfera e teknologjive informatike dhe telekomunikuese,
 - ta njohë në mënyrë aktive gjuhën angleze,
 - të ketë aftësi profesionale dhe organizative,
 - të ketë së paku pesë vjet përvojë pune, në sferën e teknologjive informatike dhe komunikuese dhe
 - ta ofrojë Programin më kualitativ për punën e MARnet-it.

Neni 12

Drejtori mund të shkarkohet edhe para përfundimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, nëse :

- vet e kërkon atë,
- nuk punon dhe nuk vepron sipas ligjit, Statutit dhe aktet e MARnet-it, ose pa arsye nuk i zbaton vendimet e Këshillit drejtues dhe të organit profesional të MARnet-it,
- me punë e vet të papërgjegjshme dhe të parregullt, i shkakton dëm të konsiderueshëm MARnet-it.

Neni 13

(1) Nëse në konkursin e shpallur nuk paraqiten kandidatë, ose nëse Këshilli drejtues nuk e zgjedh drejtorin nga kandidatët e paraqitur, shpallet konkursi i ri publik.

(2) Nëse për shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk zgjedhet drejtori ose para kohe i mbaron mandati, Këshilli drejtues pa konkurs publik do të emërojë ushtrues detyre të drejtorit, sipas rregullës nga radhët e të punësuarve në MARnet.

(3) Ushtruesi i detyrës së drejtorit, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e drejtorit të MARnet-it.

(4) Ushtruesi i detyrës së drejtorit, emërohet për kohën deri në zgjedhjen e drejtorit, e më së shumti për gjashtë muaj.

(5) Për ushtrues të detyrës së drejtor, mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet si për zgjedhje të drejtorit.

Neni 14

Drejtori i MARnet-it i kryen punët, në vijim:

- udhëheq me punën e MARnet-it,
- e prezanton dhe e përfaqëson MARnet-in,
- i propozon programin vjetor për punën e MARnet-it, statutin dhe llogarinë përfundimtare,
- e propozon raportin vjetor për punën e MARnet-it deri më 31 mars,
- e propozon raportin vjetor financiar të MARnet-it,
- e organizon realizimin e programit vjetor,
- e miraton aktin për organizimin dhe punën dhe aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- i miraton aktet lidhur me marrëdhënien e punës të punonjësve,
- i propozon aktet e përgjithshme për shfrytëzimin e shërbimeve telekomunikuese,
- formon trupa këshillues në pajtim me Statutin,
- përgjigjet për punën materiale-financiare dhe ligjshmërinë e punëve në kompetencë të tij dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Organi profesional

Neni 15

(1) Për kryerjen e punëve profesionale të lidhura me planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen me lidhjet ndërmjet shfrytëzuesve të shërbimeve telekomunikuese dhe zhvillimin e rrjetit të mbyllur telekomunikues, në MARnet themelohet këshill profesional, si organ profesional i MARnet-it.

(2) Këshillin profesional e përbëjnë përfaqësues të shfrytëzuesve të shërbimeve telekomunikuese.

(3) Numri i përfaqësuesve, mënyra e zgjedhjes dhe puna e këshillit profesional, rregullohet me Statutin e MARnet-it.

III. FINANCIMI I MARnet-it

Neni 16

Mjetet për financimin e MARnet-it, sigurohen nga:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë,
- universitetet shtetërore në lartësi prej 30%,
- të hyrat personale nëpërmjet arkëtimit të shërbimeve telekomunikuese dhe
- nga burime tjera në pajtim me ligjin (legata, dhurata, testamente etj.).

Neni 17

(1) Teprica e mjeteve e realizuar nga puna e MARnet-it, paguhet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Për mbulimin e humbjeve që mund të ndodhin gjatë punës së MARnet-it, vendos themeluesi në bazë të propozimit të Këshillit drejtues.

Neni 18

(1) MARnet-i përgjigjet për obligimet e veta, me mjetet me të cilat disponon, me të gjitha të drejtat dhe obligimet pa kufizim.

(2) Themeluesi i MARnet-it përgjigjet për obligimet e MARnet-it, që dalin nga dhënia e shërbimeve telekomunikuese.

IV. MBIKËQYRJA

Neni 19

Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe për punën e MARnet-it, e kryen Ministria e Shoqërisë Informatike.

Neni 20

Për statutin e MARnet-it, pajtim jep Ministria e Shoqërisë Informatike.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Punët profesionale dhe administrative lidhur me përgatitjen për fillimin e punës së MARnet-it, i kryen Ministria e Shoqërisë Informatike.

Neni 22

(1) Anëtarët e Këshillit drejtues, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do t'i emërojë në afat prej 30 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Këshillit drejtues në afat prej 15 ditësh nga dita e emërimit, shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit të MARnet-it, ndërsa drejtori zgjidhet në afat prej 15 ditësh, nga dita e skadimit të afatit të konkursit publik.

(3) Këshilli drejtues e miraton statutin në afat prej 60 ditësh, nga dita e emërimit të anëtarëve të Këshillit drejtues.

(4) Aktin e organizimit dhe punës dhe aktin e sistematizimit të vendeve të punës, drejtori i MARnet-it do t'i miratojë në afat prej 60 ditësh, nga dita e zgjedhjes së tij.

Neni 23

Aktet e përgjithshme të parapara me nenin 10 alineja 9 e këtij ligji, Këshilli drejtues do t'i miratojë në afat prej 30 ditësh, nga dita e miratimit të Statutit.

Neni 24

MARnet-i fillon me punë me ditën e zgjedhjes së drejtorit.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".